



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 436 , datë 16.6.2011

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.538, DATË 26.5.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LICENCAT DHE LEJET
QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE
TË LICENCIMIT (OKL), DHE DISA RREGULLIME TË TJERA
NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 36, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në kategorinë IV.1, "MINERARE OSE HIDROKARBURE", të aneksit I, që i bashkëlidhet vendimit nr.538, datë 25.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pika 3 ndryshohet dhe shtohet pika 3/1, si më poshtë vijon:


"3. Leja minerare është nënkategoria IV.1.B, e cila trajtohet sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t'iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL-ja, për secilin nga llojet specifike të kësaj lejeje, janë ato respektive të përcaktuara nga legjisllacioni minerar në fuqi.

3/1. Lejet minerare specifikohen si vijon:

- a) “Leje kërkim - zbulimi” me kodin IV. 1. B. 1;
- b) “leje shfrytëzimi” me kodin IV. 1. B. 2;
- c) “leje kërkim – zbulim - shfrytëzimi” me kodin IV. 1. B. 3.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS**

NASIP NAÇO



NR.PROT.1868/1
DATË 29.6.2011

MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL)
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

REPUBLIKË SHQIPËRISË - ZYRTARE
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Gjergj LEZHJA
Sekretar i Përgjithshëm